

MBI AUDITIMIN E PERFORMANCËS TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË DOGANAVE, TIRANË

Në bazë të programit të auditimit “Mbi efektivitetin dhe ekonomikitetin e ambienteve të marra me qira nga administrata doganore” për periudhën 01.01.2014 deri 31.08.2015 me numër nr. 600/1, datë 16.09.2015, ndryshuar me nr. 600/2 datë 20.10.2015, Kontrolli i Lartë i Shtetit ushtroi auditimin e performancës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe disa Degë Doganore.

Raporti përfundimtar i auditimit dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 184, datë 31.12.2015.

Bazuar në nenet 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", me shkresën nr. 600/24 datë 31.12.2015, i është dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet.

Nga auditimi u evidentua se Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur sigurimit të ambienteve për ushtrimin e aktivitetit nga degët doganore dhe konkretisht në:

- Mos përlogaritjen e nevojave, moszbatimin e projekteve, gjë e cila ka çuar që investimet e kryera për sigurimin e ambienteve për degët doganore, të jenë jashtë funksionalitetit, duke mos siguruar asnjë zgjidhje permanente dhe optimale të këtij problemi.
- Vendimmarrjen për mënyrën e sigurimit të ambienteve, nuk e ka kaluar përmes një vlerësimi dhe analize kosto/përfitim, ku të përcaktohet edhe struktura përgjegjëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, e cila të ndjekë dhe monitorojë këtë proces, por është lënë në kompetencë të plotë të degëve doganore.
- Mungesën e një akti administrativ (urdhër/udhëzues) të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, ku të unifikohet dhe përcaktohet mënyra, se si do të procedohet nga degët doganore, për marrjen me qira të ambienteve. Kjo ka sjellë që degët doganore të procedojnë në mënyra të ndryshme, si për procesin e negocimit, apo konkurimit, ashtu edhe në mënyrën e lidhjes së kontratave të qiramarrjes.
- Mungesën e vlerësimit të mënyrave alternative, si afati i vetëshlyerjes së investimit në raport me shpenzimet korente të qiramarrjes. Moskryerja e investimeve afatgjata (ndërtimi i objekteve për ambiente për këto degë doganore), ka sjellë kosto shtesë, të barasvlershme me pagesat e qiramarrjes, të cilat janë shpenzime të pakthyeshme, si dhe nuk ofrojnë zgjidhje optimale për sa i përket funksionalitetit.

Nisur nga konkluzionet e mësipërme dhe rezultatet e punës audituese, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të këtij shërbimi, bazuar në nenet 10, 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

K Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme :

Rekomandim nr. 1. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të nxirret një akt administrativ, i cili të përcaktojë dhe të unifikojë procedurën që duhet të ndiqet në rastet e marrjes me qira të ambienteve, në lidhje me procesin e konkurrimit, negocimit dhe lidhjes së kontratave. Gjithashtu, të hartojë një kontratë tip, për t’u zbatuar nga administrata doganore, në rast të marrjes me qira të objekteve për ushtrimin e aktivitetit të tyre.

Rekomandim nr. 2. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të përcaktohet në Rregulloren e Brendshme, struktura kompetente në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, si për shembull Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, e cila të ketë përgjegjësinë për monitorimin dhe vendimmarrjen në rastet e marrjes me qira të ambienteve, duke u bazuar në një analizë të thelluar kosto/përfitim.

Rekomandim nr. 3. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të merren masa të menjëhershme, për marrjen në shqyrtim dhe në analizë të të gjitha kontratave ekzistuese të lidhura nga degët doganore me të tretët, për ambientet e marra me qira, me qëllim identifikimin e mangësive dhe shkeljeve, duke vlerësuar mundësitë ligjore dhe teknike për rishikimin e tyre.

Rekomandim nr. 4. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të përcaktohen standarde të funksionimit normal të veprimtarisë së administratës doganore, në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimit ndaj subjekteve tatimpaguese, përsa i përket sipërfaqes së ambienteve, vendndodhjes së zyrave të administratës, shesheve, parkimit, distancave midis zyrave të administratës dhe ambienteve të shërbimit.

Rekomandim nr. 5. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duhet të fillojë negocimi me institucione të tjera shtetërore si, Ministria e Financave, Autoriteti Portal dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik Turizmit Tregtisë dhe Sipërmarrjes, që për degët doganore, të cilat janë të kushtëzuara të zhvillojnë veprimtarinë e tyre në portet detare, të krijohet mundësia e shfrytëzimit të ambienteve ekzistuese, apo ndërtimit të objekteve “Degë Doganore” në territorin e portit. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të fillojë bashkëpunimi me strukturat përkatëse për plotësimin e nevojave urgjente për ambiente të Degës së Doganës Rinas, duke bërë të mundur gjetjen e alternativave të mundshme dhe zgjidhjen e problemit.

Rekomandim nr. 6. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duhet të rishikojë këndvështrimin e saj në lidhje me sigurimin e ambienteve për ushtrimin e aktivitetit nga degët doganore, për gjetjen dhe zbatimin e alternativave më efikente dhe ekonomike, duke analizuar:

- Vlerësimin e tij nisur nga leverdishmëria ekonomike, vlerësimi i raportit qira/investim.
- Vlerësimin e tij nisur nga fakti se sa janë plotësuar nevojat, nga zgjidhja aktuale.
- Vlerësimin e tij në drejtim të funksionalitetit dhe cilësisë së ofruar aktualisht.
- Sa këto kanë siguruar përdorimin me efektivitet dhe efikasitet të parasë publike, dhe cili do ishte ndikimi i kryerjes së investimeve afatgjata, në drejtim të rritjes së cilësisë së shërbimit dhe të ardhurave.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 184, datë 31.12.2015, është ngarkuar Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Shënim: Auditimi u krye përgjatë periudhës 17.09.2015 deri më 26.11.2015, nga audituesit shtetëror: Edvin Stefani, përgjegjës grupi, Brunilda Zeneli dhe Agron Opari anëtarë, u mbikëqyr nga Drejtori i Departamentit zj. Albana Agolli, u shqyrtua nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, z. Ermal Yzeiraj dhe Drejtori i Përgjithshëm zj. Manjola Naço.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT